



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-4233/21 datë:16.02.2021



Npi – 01/41 datë: 17.02.2021

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 12.02.2021 është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SOLEMNE TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES

E mbajtur më: 17.02.2021, (e mërkurë) në ora 10.⁰⁰ h. në sallën e Kuvendit, me rastin e 13 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë të Republikës së Kosovës më 17.02.2008.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: znj.Medina Brahaj, z.Perparim Ramusa, z.Shefki Dauti, z.Herolind Selmani, z.Reshat Mujota, z.Milot Deliu, znj.Fatmire Ferati, z.Naim Zejna, znj.Zarife Rexhaj, z.Ruzhdi Jashari, z.Besnik Seferi, znj.Marigona Pajaziti, znj.Adelina Beqaj, znj.Diarta Vishesella, dhe z.Muhamet Ademaj.

Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Naim Ismajli, Drejtorët, Përfaqësues të Shoqatave të UÇK-së; Përfaqësues të QKMF-së, dhe zyrtarë të tjerë. Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit znj.Medina Brahaj, e cila i njoftoi të pranishmit me:

REND DITE

1. Hapja e mbledhjes nga Kryesuesja e Kuvendit,
2. Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës.

Pika 1

Hapja e mbledhjes nga Kryesuesja e Kuvendit

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit tha: Me këtë rast dua që të ju uroj të gjithë qytetarëve dhe të pranishmëve në sallë 13 Vjetorin e Pavarësisë së Kosovës.

Jemi mbledhur sot në këtë seancë solemne, për nder të 13 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, shtetit tonë të ri, andaj më lejoni që në emër timin dhe të Kuvendit të Komunës t'ju uroj këtë ditë të veçantë për popullin tonë, ndërsa në veçanti të uroi familjet e Dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe të gjithë ata që u sakrifkuan që ne këtë ditë ta festojmë të lirë. Në vazhdim do të ja jap fjalën Kryetarit, Naim Ismajli, për një fjalë rasti.

Pika 2

Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Fajlën ja dha Kryetarit, Naim Ismajli.

Kryetari, z.Naim Ismajli; Pasi përshëndeti të gjithë, para të pranishmëve gjatë seancës solemne, në fjalimin e tij tha: " Kjo ditë është ditë e shenjtë për të gjithë ne dhe për gjeneratat që do të vijnë.

Është jetësimi ëndrrës shekullore dhe kurorëzimi i sakrificave që edhe ne të jetojmë të lirë në shtetin tonë. Sot, e shënojmë Ditën e Pavarësisë pa shtatë çlirimtarët tanë, pa ata të cilët janë themelues të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të lirisë e të Pavarësisë së Kosovës. Kjo është ditë që na bënë krenar për të kaluarën tonë, duke mos i harruar kurrë dhe duke qenë gjithmonë mirënjohës për të rënë për Lirinë e vendit tonë, sepse gjaku i tyre u bë gurthemel për Pavarësinë e Kosovës.

Uroj familjet e Dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), invalidë e veteranë të UÇK-së si dhe të gjithë ata që kontribuan në ngritjen e institucioneve dhe shtetndërtimin.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; E falënderojmë Kryetarin Ismajli për këtë fjalë rasti, dhe tani ju ftoj që pas seancës solemne, së bashku me Kryetarin Ismajli së bashku me nënkryetarin Jakupi, e me stafin udhëheqës institucional, e këshilltar të Kuvendit, përfaqësues të Shoqatave të dalura nga lufta, veteranë e familjarë të dëshmorëve dhe qytetarë të komunës së Shtimes, të bëjmë homazhe pranë varrezave të dëshmorëve dhe martirëve tanë në Shtime, Reçak dhe Mollopolc.

Ju falënderoj për pjesëmarrjen e juaj në mbledhjen solemne të Kuvendit, dhe mbledhjen e përfundoj në ora 10.20h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj

